

VENDIM
Nr.40, datë 24.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HEC I TERVOLIT” SHPK PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT,
INSTALIMIT DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit”, neni 10, pika 1, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.3.2008, pasi shqyrtoi aplikimin për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike paraqitur nga shoqëria “HECI I TERVOLIT” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC i Tervolit” sh.p.k., për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë elektrike (HEC i Tervolit).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për procedurat që do të ndiqen në vijim të kërkesave të rregullores për procedurat e licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta